

AKT THEMELIMI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

“OL-AR UNION sh.p.k”

Sot me date 06 Qershor 2022, ne Tirane te nenshkruarit:

Znj. Ola Sulka, e bija e Markut, e datelindjes. 16.01.1989, lindur ne Ulez dhe banuese ne Tirane, Rruga “Sitki Çiço, Nd.1, H.2, Njesia Administrative Nr.3, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr. 034225861 dhe Numer Personal: I95116004E

Znj. Marsela Sulka, e bija e Vladimirit, e datelindjes. 03.09.1998, lindur ne Tirane dhe banuese ne Tirane Rruga “Sitki Çiço, Nd.1, H.2, Njesia Administrative Nr.3, shtetase shqiptare, madhore me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet leternjoftimit me nr. 036593701 dhe Numer Personal: J85903050M,

Ne perputhje me Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008, “Per tregaret dhe Shoqerite Tregtare” (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723 date 3.5.2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit” (i ndryshuar) kemi vendosur te themelojme nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emeruar “OL-AR UNION sh.p.k (me poshte referuar si “Shoqeria”), duke neneshkruar kete Akt Themelimi, Aktiviteti i kesaj Shoqerie do te rregullohet nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij Akti Themelimi.

Neni 1

Te themelojme nje shoqeri tregtare te tipit Shoqeri me Pergjegjesi te kufizuar. Emertimi i shoqerise do te jete “OL-AR UNION” sh.p.k.

Neni 2

Kohezgjatja e aktivitetit te Shoqerise do te jete e pakufizuar, duke filluar qe prej dates se regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

Neni 3

Selia e Shoqerise ndodhet ne Adresen: Njesia Bashkiake Nr.5, Bulevardi “Bajram Curri” (Ish Shqiperia e re) Pallati Nr.25, Shkalla 2, Dyqani Nr.6 (ish apartamenti 12), kati i pare, Tirane.

Shoqeria ka te drejte te hape dege dhe filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithë vendin, brenda ose jashte territorit te vendit, gjate aktivitetit te saj.

Neni 4

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte si vijon:

Aktivitete ne fushen e konsulences dhe administrimit, ne fushen e biznesit dhe ate financiare dhe konvertimin e monedhes,

Kembim valutor,

Agjent per transferim parash ne llogari te nje subjekti financiar jobankar,

Agjent Komisioner, aktivitetin e marketingut apo perfaqesuesit per firma te ndryshme me te vendit apo te huaja, Sherbim Union Net, Western Union,

Veprimtari e agjentit per sherbimin e pagesave per te tretet ne emer dhe per llogari te nje subjekti financiar jobanke.

Shoqeria do te jete gjithashtu e afte te kryeje llojet e veprimtarive tregtare qe nuk ndalohen nga legjislacioni shqiptar,

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga:

Kontributet ne para

Ato sillen ne para dhe depozitohen konform ligjit ne nje llogari te hapur ne emer te shoqerise ne formim, ne banken Union Bank ne Tirane.

Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre si me poshte:

- Ortaku themelues Znj. Ola Sulka Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.275.000,00 (njemilion e dyqind e shtatedhete e pese mije) leke qe perben 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise;

- Ortaku themelues Znj.Marsela Sulka Zoterues i 1 (nje) kuote me vlere te pergjithshme 1.225.000,00 (Njemilion e dyqind e njezet e pese mije) leke qe perben 49 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te rrisin kapitalin e Shoqerise ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Shoqerise. Detyrimet e ortakeve te shoqerise kundrejt Shoqerise do te mbulohet vetem me pjesen e kapitalit te paguar prej tij.

Totali i kontrubeteve:

Kontributet ne para arrijne ne ***2.500.000,00 leke (dymilioneepeseqindmije leke)***

Totali i kontributeve arrin ne 2.500.000,00 leke (dymilioneepeseqindmije leke)

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise perbehet nga Kontribut ne Para, vlera totale e kontributit eshte 2.500.000,00 (Dymilionepeseqindmije) Lekë, numri i pjesëve eshte 2, kuotat si me poshte :

Ortaku Znj. **Ola Sulka**; numri i pjesëve 1.00, kuota e pjesemarrjes 51,00% , vlera e kontributit 1.275.000 ,00 Leke;

Ortaku Znj. **Marsela Sulka**; numri i pjesëve 1.00, kuota e pjesemarrjes 49,00% , vlera e kontributit 1.225.000 ,00 Leke;

Neni 6

Shoqeria vepron nen rregjimin e pronës private dhe merr persiper vetes te drejatat dhe detyrimet kontraktore dhe jashtekontraktore.

Shoqeria eshte e organizuar ne organet e meposhtme:

-Asambleja e Pergjithshme;

-Administratori;

Kompetencat e Asmblese se Pergjithshme si dhe te administratorit te Shoqerise jane te parashkruara ne Statutin e Shoqerise.

Neni 7

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike permbajtja e tyre per te tretet, e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe jane percaktuar si te tilla nga administratori i shoqerise.

Neni 8

Marredheniet e punës rregullohen nepermjet kontrates se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqeria merr persiper te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit jane te detyruar qe ta respektojne Statutin e kesaj Shoqerise dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te pergjigjen per demet qe shkaktojne kesaj Shoqerise me veprimet dhe mosveprimet e tyre.

Neni 9

Ne rast se Shoqeria do te mbyll aktivitetin e saj per cdo lloj arsye, Asambleja e Jashtezakonshme e Ortakeve te Shoqerise, percakton menyren e likuidimit, emerone nje ose me teper likuidatore dhe pergatit te gjitha dokumentet e nevojshme per c'registrimin e saj nga Qendra Kombetare e Biznesit.

Neni 10

Kontrolli mbi veprimtarine e Shoqerise si dhe gjithe aktivitetin e Shoqerise i besohet nje eksperti kontabel. Ky ekspert do te emerohet dhe qendroje ne detyre sipas parashikimeve qe ben ligji per

espertet dhe mund te rizgjidhet. Asambleja e Pergjithshme cakton edhe shperblimin perkates kur nuk ka norma te vecanta ligjore.

Neni 11

Viti financiar fillon ne 1 Janar dhe mbaron ne 31 dhjetor te secilit vit. Perjashtim, viti i pare financiar fillon nga data e rregjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 dhjetor. Administratori merr masat me qellim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te ceshtjeve te mesiperme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e tjera do ti kalojne ortakeve te Shoqerise.

Neni 12

Akti i Themelimit eshte hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe.

Per sa eshte shprehur ne kete Akt Themelimi, i referohemi ligjit 9901, date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" (i ndryshuar).

Te nenshkruarit deklarojne se te gjitha pjeset jane te nenshkruara teresisht, derdhur plotesisht dhe ndare midis tyre sic tregohet me larte.

ORTAKET

E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"OL-AR UNION " sh.p.k."

(Ola Sulka)
Emer Mbiemer Nenshkrimi

(Marsela Sulka)
Emer Mbiemer Nenshkrimi